



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BULQIZË
KESHILLI BASHKIAK**

Nr. ____ prot

Bulqizë më ____ . ____ . 2018

VENDIM

Nr. 2 Datë 31.01.2018

PËR

**DHËNIEN E BURSAVE TE SHTETIT PËR NXËNËSIT DHE STUDENTËT NË
INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE BANORË TE BASHKISË BULQIZË PËR
VITIN SHKOLLOR 2017-2018.**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, 19 e 28 të ligjit nr. 69/2012, «Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë », te ndryshuar, të pikes 2, nenit 32, të ligjit nr.15/2017 « Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë », të neneve 1 e 5 të ligjit nr. 10/289, datë 17.6.2010 « Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëherëshme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brëndshëm , të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës », të nenit 2 të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 « Për statusin e invalidit », të ndryshuar, te nenit 6 të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996 « Për statusin e jetimit », të ndryshuar, te nenit 8 të ligjit nr.8098, datë 28.03.1996, « Për statusin e të verbërit », të ndryshuar, te nenit 8, të ligjit nr.8626, datë 22.06.2000. Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik », të ndryshuar, te nenit 32, të ligjit nr.9355, datë 10.03.2005, «Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore » të ndryshuar, si dhe të ligjit nr: 30/2016, ligjit nr.139 datë 17.12.2015 « Për Veteqeverisjen Vendore » , « Për buxhetin e vitit 2017 të ndryshuar » me propozimin e Ministrise se Arsimit, Sportit dhe Rinise dhe ministrit te Financave dhe Ekonomise, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 753 prot. datë 13.12.2017, « Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentet e shkëlqyer. studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë Urdherit Nr 658 date 27.12.2017, Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinise « Për planin e shpërndarjes së bursave për nxënësit e Arsimit Parauniversita ne institucionet arsimore publike për vitin shkollor 2017-2018, që i bashkangjitet ketij vendimi : **Keshilli Bashkiak ne mledhjen e tij te dates 31.01.2018 pasi diskutoi dhe analizoi rreth projektit te paraqitur nga Drejtoria e Arsimit, Turizmit, Kultures, Rinise dhe Sporteve me 14 vota pro, asnje kunder dhe asnje abstenim**

VENDOSI

1-Te miratoje dhenien e bursave për nxënësit/studentet, banorë të Bashkisë Bulqizë, mbështetur në V K M nr. 753 datë 13.12.2017 « Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentet e shkëlqyer,

studentet që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë dhe Urdherit nr. 658, datë 13.12.2017« Për planin e shpërndarjes së bursave për nxënësit/studentet e Arsimit Parauniversitar në institucionet arsimore publike për vitin shkollor 2017-2018 sipas tabelave bashkangjitur.

Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut Diber.

PER KESHILLIN BASHKIAK

SEKRETARI
Agim TUCI



KRYETARI
Gazmend KENGA

